



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS KAMENICË

Numri i lëndës: 2023:265834

Datë: 05.04.2024

Numri i dokumentit: 05550178

C.nr.896/2023

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Artan Abazi, me bashkëpunëtoren profesionale Teuta Gashi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit T.L. nga të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Vlora Kadriu, avokate nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Kamenicës - Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i inflacionit në pagë, me vlerë të kontestit: 679.15 euro, jashtë seance gjyqësore, me datë 01.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit T. L. nga dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Kamenicës që në emër të pagesës shtesë të përqindjes së inflacionit, për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datë 21.11.2022, t'ia paguaj paditësit shumën prej 679.15 euro, që të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% duke llogaritur nga data 23.11.2023 si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj paditësit shumën prej 124.00 €, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, më datë 23.11.2023 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e inflacionit në pagë.

Në padi, ka theksuar se i njejtë është i punësuar tek e paditura me Kontratë Pune, me kohë të pacaktuar, ndërsa nuk është kompensuar nga e paditura për shkallën e përqindjes së inflacionit, përkundër faktit se e paditura ka qenë e detyruar për këto kompensime. Bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës, Kontratave Kolektive të Arsimit të datave 18.04.2017 dhe 21.01.2021 e përqindjes vjetore së llogaritur nga Enti i Statistikave të Republikës së Kosovës, ka theksuar se paditësit i takojnë këto shpërblime. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyroj të paditurën në kompensimin e shumave të aprovuara

si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 €, për përpilim të padisë; 20.00 € për taksë gjyqësore, apo shumën e përgjithshme në shumën prej 124.00 euro.

E paditura në përgjigjen në padi, ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar duke theksuar se e paditura nuk ka legjitimitet real pasiv për faktin se për zbatimin e Vendimit Nr.01/33 të datës 29.08.2008, shprehimisht në pikën 8 të këtij vendimi është përgjegjëse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shërbimeve Publike, duke shtuar se me qëllim të implementimit të vendimeve të Qeverisë, një shumë e caktuar financohet nga niveli komunal, kurse pjesa tjetër nga niveli qendror.

Gjykata ka vlerësuar parashkrimin e kërkesës bazuar në kundërshtimin e të paditurës, por ka gjetur se periudha kohore e kërkuar për këtë kompensim nuk është e përfshirë në parashkrim siç e pretendon e paditura, pasi bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 23.11.2023, kurse kërkesa është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht nga data 01.01.2021 (më saktësisht 2 vite).

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi është i punësuar te e paditura (fakt i provuar edhe nga Kontrata e Punës me nr. 354, e datës 05.09.2016, paga bazë e të njejtit është 421.00 euro, (fakt i provuar nga lista e pagës në emër të paditësit); ndërsa inflacioni vjetor për vitin për vitin 2019 është 2.7 %, për vitin 2020 është 0.2 %, për vitin 2021 është 3.4 % dhe për vitin 2022 është 11.6 % (fakt i provuar nga llogaritja e shkallës mesatare të inflacionit nga Enti i Statistikave të Kosovës).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vetë e paditura dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës, brenda kufijve të kompetencës së vetë, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga të njëjtat gjykata provoi se paditësit janë të punësuar te e paditura, dhe shkalla e inflacionit në vit për vitet 2020, 2021 dhe 2022 është e përcaktuar si më lartë.

Gjykata duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, e as gjendjen faktike, por vetëm bazën e kërkesëpadisë, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor, pasi themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 10 se “Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2017 aplikohen për periudhën 18.04.2017 – 21.01.2021 dhe për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.40/2023 të datës 27.02.2023 dhe nr. 214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga të theksuarat më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se paditësi i cili është i punësuar te e paditura nuk është kompensuar për shkallën e inflacionit sipas përqindjes së përcaktuar nga Enti i Statistikave të Kosovës, ndërsa ky kompensim arrin shumën e aprovuar, të cilat janë të llogaritura në bazë të përqindjes për vitin përkatës dhe periudhës kohore të kërkuar për këto vite.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës me përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se të njëjtat janë të pabazuara, pasi KKAK është e zbatueshme për të të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit, gjegjësisht komunat-DKA, ku në këtë rast është e paditura, prandaj e njëjta ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të cilat derivojnë nga KKAK. Sa i përket faktit se nuk ka pas inflacion të theksuar, gjykata vlerëson se kjo rrethanë është përcaktuar me shkallën sipas Entit të Statistikave të Kosovës.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ashtu që ia njohi kërkesën e shpenzimeve sa i përket përpilimit të padisë dhe taksës gjyqësore, si shpenzime të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tariferor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Dega në Kamenicë
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.896/23, datë 01.03.2024

Gjyqtari,
Artan Abazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.